URDHËR
Nr.121/1, datë 19.1.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 3 dhe 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, "a" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Institutit të Mjekësisë Ligjore jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km të lëshohen nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore.
2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit".
3. Ngarkohet Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani